



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 21 dhjetor 2015
Nr. ref.:RK872/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI173/14

Parashtrues

Staja Savić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komisionit për Kërkesa
Pronësore të Kosovës, KPCC/D/C/264/2014, të 21 tetorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Staja Savić nga Ferizaj, me vendbanim të tanishëm në Kralevë, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin KPCC/D/C/264/2014, të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) të 21 tetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të KKPK-së KPCC /D/C/ 264/2014, të 21 tetorit 2014, në lidhje me kërkesën e parashtruesit për pronë private KPA 15121, të 1 shtatorit 2006.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 dhjetor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 22 maj 2014, parashtruesi u njoftua në lidhje me regjistrimin e kërkesës dhe u kërkua nga ai që të plotësojë formularin e kërkesës dhe të dorëzojë dokumente shtesë relevante për pretendimet e tij.
8. Më 16 janar 2015, parashtruesi plotësoi formularin e kërkesës dhe dorëzoi dokumentet shtesë.
9. Më 19 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentet shtesë, duke përfshirë vendimin e KKPK-së lidhur me kërkesën e tij pronësore private.
10. Më 15 shtator 2015, Gjykata i dërgoi AKP-së një kopje të kërkesës dhe kërkoi që të informohet në lidhje me statusin e kërkesës së parashtruesit.
11. Më 18 shtator 2015, AKP-ja dorëzoi dokumente dhe informata shtesë në lidhje me statusin e kërkesës së parashtruesit.
12. Më 25 shtator 2015, një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme).
13. Më 30 shtator 2015, Dhoma e Posaçme njoftoi Gjykatën se parashtruesi nuk ka parashtruar ankesë tek ajo.

14. Më 10 nëntor 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 20 mars 1992, parashtruesi i kërkesës, si menaxher i ndërmarrjes “Enigma” nga Ferizaj, lidhi marrëveshje me ndërmarrjen NSHT “TRGOPROMET” gjithashtu nga Ferizaj. Marrëveshja ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj, dhe me të përcaktohej se parashtruesi i kërkesës i huazon një shumë të caktuar të hollash NSHT “TRGOPROMET”, e cila duhet t’i kthehet parashtruesit të kërkesës deri më 10 prill 1992, si garanci, se kredia do të paguhet në datën e paraparë NSHT “TRGOPROMET” do të lë hapësirën e papërdorur magazinuese në sipërfaqe prej 52 m² në Prishtinë, që në rast se NSHT “TRGOPROMET” nuk e paguan kredinë në datën e paraparë, parashtruesi ka të drejtë të shesë objektin e magazinës së hipotekuar, dhe se, Gjykata Ekonomike në Prishtinë është autoriteti kompetent në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje midis palëve të asaj marrëveshjeje.
16. Rezulton se NSHT “TRGOPROMET” nuk ia ka paguar kredinë parashtruesit të kërkesës sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtrroi padi në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë, me kërkesë që të njihet si pronar i lokalit të hipotekuar-magazinës në Prishtinë.
17. Më 28 korrik 1992, Gjykata Ekonomike në Prishtinë, me Aktgjykimin VI. P. nr. 3851/92 aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, konfirmoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i hapësirës së depos së hipotekuar, se NSHT “TRGOPROMET” është e obliguar që të transferojë pronësinë dhe përdorimin e papenguar të lokalit të hipotekuar - depo brenda 8 (tetë) ditësh nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, dhe se, NSHT “TRGOPROMET” duhet t’ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shpenzimet e procedurës gjyqësore. Gjykata Ekonomike arsyetoi, *inter alia*, se në bazë të dëshmive të paraqitura, është përtej çdo dyshimi se objekti i magazinës ishte hipotekuar, që NSHT “TRGOPROMET” nuk ia ka paguar kredinë parashtruesit të kërkesës, dhe se, në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, parashtruesi i kërkesës e ka fituar të drejtën për të transferuar objektin e kontestuar të magazinës në pronësi të tij.
18. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, del se parashtruesi i kërkesës ndërmjet viteve 1992 dhe 1999 e kishte shfrytëzuar dhe rinovuar objektin e magazinës, që i ishte dhënë atij sipas kushteve të marrëveshjes dhe vendimit të mësipërm të Gjykatës Ekonomike. Në vitet 1998-1999, shpërtheu lufta në Kosovë dhe parashtruesi i kërkesës, së bashku me familjen e tij iku në Republikën e Serbisë.
19. Më 1 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për pronë private KPA15121 në AKP, duke deklaruar se prona e tij private kishte humbur si rezultat i rrethanave që u krijuan gjatë viteve 98/99 në Kosovë, se ai e ka humbur pronën e tij më 12 qershor 1999, se ai është pronar i objektit të magazinës në Prishtinë sipas marrëveshjes së 20 marsit 1992, se prona e tij aktualisht është uzurpuar nga një palë e tretë dhe se ai duhet të kompensohet, për shkak se prona e tij është shfrytëzuar nga viti 1999 pa pëlqimin e tij.

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu bashkëngjiti një vendim të Gjykatës Ekonomike në Prishtinë, të 22 gushtit 1996 për regjistrimin e pronës.

20. KKPK-ja, një organ në kuadër të AKP-së, nuk vendosi lidhur me kërkesën e parashtruesit deri më 21 tetor 2014. Gjatë kësaj periudhe kohore, parashtruesi i kërkesës u ankua për zvarritjen e procedurave në UNHCR, EULEX, Qeverinë e Kosovës, bëri ankesa të freskëta në AKP dhe përfundimisht parashtruesi i kërkesës në Gjykatë më 1 dhjetor 2014. AKP-ja i ishte përgjigjur parashtruesit të kërkesës që ata nuk mund të vendosin për kërkesën e tij për shkak të numrit të madh të rasteve të pazgjidhura, diku rreth 43,000 kërkesa, dhe se, kërkesa e tij do të shqyrtohet në pajtim me prioritetin e kërkesave të paraqitura në AKP.
21. Më 21 tetor 2014, KKPK-ja me Vendimin KKPK/D/C/264/2014 konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka humbur mundësinë e tij për të ushtruar të drejtën e tij pronësore si rezultat i konfliktit të viteve 1998-99, por si rezultat i procesit të mëvonshëm të privatizimit, prandaj, kërkesa e parashtruesit bie jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe për këtë arsye hidhet poshtë. Me Vendimin e KKPK-së gjithashtu përcaktohet se brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga AKP-ja me vendimin e KKPK-së lidhur me kërkesën, pala mund të parashtrtojë ankesë nëpërmjet Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimit të tillë. Ankesa mund të parashtrohet për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, si dhe për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike.
22. Në vendimin e lartcekur të KKPK-së në pjesën e tij relevante, theksohet:

Kërkesat nr. 10676, 11322 dhe 15121, të referuara në pjesën D të listës së bashkëngjitur, janë paraqitur nga paraqitësi përkatës i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në të gjitha këto kërkesa, paraqitësit e kërkesave kanë pretenduar se ata ose familjet e tyre kanë humbur pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të viteve 1998-99. Sekretaria Ekzekutive ka siguruar informatat që pronat e kërkuara janë pasuri e ndërmarrjeve të ndryshme shoqërore ("NSH") dhe si të tilla janë vendosur nën administrim të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe më vonë në vitin 2002 të pasueses së saj, Agjencisë Kosovare të Privatizimit). Sipas përfaqësuesit të AKP-së, pronat komerciale të cilat u takojnë këtyre NSH-ve tashmë janë privatizuar ose janë në procesin e likuidimit. Pastaj, Sekretaria Ekzekutive ka vërtetuar që pronat e kërkuara në kërkesat nr. 10676 dhe 15121 tashmë i janë shitur palës së tretë përmes procesit të privatizimit".

Dispozitat relevante ligjore

RREGULLORJA e UNMIK-ut NR. 2006/50 MBI ZGJIDHJEN E KËRKESAVE LIDHUR ME PRONËN E PALUAJTSHME PRIVATE, DUKE PËRFSHIRË PRONËN BUJQËSORE DHE ATË KOMERCIALE

Kapitulli IV
E drejta në ankesë
Neni 12

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.2 Përveç nëse me këtë Rregullore apo me ndonjë urdhëresë administrative me të cilën zbatohet kjo Rregullore parashihet ndryshe, dispozitat e Ligjit mbi procedurën civile zbatohen përshtatshëmrisht në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme.

12.3 Ankesa mund të paraqitet nëse:

- (a) Vendimi përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtës lëndore a procedurale ose
- (b) Vendimi bazohet në fakte jo të plota apo në vlerësimin e gabuar të fakteve.

Komentet e AKP-së

Në pjesën relevante të përgjigjes së AKP-së (Shih, paragrafin 12 më lart) në lidhje me statusin e kërkesës së parashtruesit theksohet: “Komisioni pas shqyrtimit të shkresave të lëndës me vendimin KPCC/D/C/264/2014, datë 21/10/2014/ vendosi që kërkesa e parashtruar nga z. Savić të hidhet poshtë për shkak se binte jashtë juridiksionit të Komisionit. Me vendimin e Komisionit janë njoftuar palët në procedurë ndërsa parashtruesi i kërkesës z. Staja Savić ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Komisionit. Ju lutem të jeni të informuar se ankesa e parashtruar nga z. Savić sipas procedurave standarde është në procesin e përkthimit dhe më pas do të dërgohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, Kolegjin e Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vendimmarrje”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

- 23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “Agjencia Kosovare e Pronës, Kërkesa për pronën private KPA 15121, e datës 01.09.2006, Dardania Kurriz 5/9, hapësira magazinuese 52 m² e rrënuar, pas rekonstruktimit është fituar një hapësirë afariste prej 104 m², lokali në katin përdhës dhe galeria në katin e parë. Deri në ditën e sotme kërkesa ime nuk është zgjidhur, ndërsa uzurpatori qe 15 vjet në mënyrë të paligjshme shfrytëzon hapësirën time afariste, të cilën e lëshon me qira, falë asaj që Agjencia Kosovare e Pronës është duke e zvarritur zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore në të cilat nuk ka asgjë kontestuese, përveç vullnetit të mirë”.
- 24. Përkitazi me pretendimin për zvarritjen e procedurave, parashtruesi theksoi: “Sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 22 paragrafi 1, neni 6 (gjashtë) i KEDNJ-së janë cenuar të drejtat e mia pronësore, njerëzore dhe të drejtat e lirisë, gjithashtu është cenuar e drejta ime për shqyrtim brenda një afati të arsyeshëm”.

25. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata: *“Dëshiroj që lokali im i cili ndodhet në Prishtinë në lagjen Dardania, Kurriz 5/9 të kthehet në pronësinë time, sepse ai është e vetmja pronë nga e cila e kam mbajtur familjen time pesë anëtarshë. Ai është në pronësinë time prej vitit 1992 dhe unë kam investuar mjete shumë të mëdha në rekonstruktimin e tij. Derisa unë me familjen time pesë anëtarshë jetoj nga lëmosha dhe ndihmat dhe e kam statusin e personit të zhvendosur edhe pse jam shtetas i Kosovës dhe dëshiroj të kthehem në Kosovë, pronën time e shfrytëzon M.S. nga Prishtina”.*
26. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Nuk ekziston ndonjë ankesë tjetër, vetëm Agjencisë Kosovare të Pronës, Kërkesa për pronë private KPA 15121, e datës 01.09.2006. Unë kam menduar se AKP është i vetmi institucion shtetëror i cili është i ngarkuar për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore. Unë jam një njeri i paditur dhe nuk kam pasur mundësi për t'i shfrytëzuar mjetet e tjera juridike sepse nuk kam pasur mjete për këtë”.*
27. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata *“të konstatojë se vendimi i KKPK është jokushtetues”.*

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
30. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:
- "Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
31. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 1 (b), i cili parasheh:
- (1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
- ...
 (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar...
32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit për pronë private, siç dëshmohet nga përgjigja e AKP-së dhe e Dhomës së Posaçme, është dërguar në Kolegjin e Apelit të AKP-së në Gjykatën Supreme për shqyrtim të mëtejshëm.

33. Nga kjo rrjedh, se kërkesa është parashtruar para kohe në këtë Gjykatë. Megjithatë, parashtruesi kërkon nga Gjykata "të shpallë vendimin e KKKP-së si jokushtetues".
34. Me një kërkesë të tillë parashtruesi në një mënyrë kërkon që Gjykata ta lirojë atë nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj.
35. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike, ai duhet të tregojë se: i) mjeti juridik në të vërtetë ishte shfrytëzuar, ii) mjeti juridik ishte i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin e tij, dhe iii) kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për shfajësimin e parashtruesit nga kërkesa për të shteruar të gjitha mjetet juridike. Nga dokumentet që gjenden në kërkesë, nuk ka asgjë që tregon se parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret për tu liruar nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike në dobi të tij (Shih, për shembull, Rasti nr. KI116/14, parashtruesi i kërkesës *Fadil Selmanaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 janarit 2015).
36. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Rasti KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë* Aktvendimin për papranueshmëri i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
37. Gjykata rithekson se nuk mund t'i zëvendësojë me gjetjet e veta gjetjet e gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike në Republikën e Kosovës; parimi i subsidiaritetit është shumë i rëndësishëm sepse i ofron mundësinë parashtruesit të kërkesës të ngrejë çështjen e faktit dhe të ligjit në gjykatat e rregullta; dhe lidhur me çështjet e faktit dhe të ligjit, gjykatat e rregullta janë të obliguara me Kushtetutë dhe me ligj të vërtetojnë çështjet e tilla (ligjshmërinë dhe faktet), të cilat, megjithatë, nuk janë brenda juridiksionit të kësaj Gjykate.
38. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk mund të shqyrtojë thelbin e kërkesës së parashtruesit pa paragjykuar rezultatin e procedurës pranë Gjykatës Supreme.
39. Duke pasur parasysh të gjitha të lartcekurat, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.
40. Nga kjo rrjedh se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak të mosshterjes së të gjitha mjeteve juridike siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

